

# FIF - Huaja II për NMVM - KEP

Lokacioni:

Kosovë

Projekti numër:

54744

Sektori i biznesit:

Institucione financiare

Lloji i njoftimi:

Privat

Kategoria mjedisore:

FI

Data e aprovimit:

25 korrik 2023

Statusi:

**Aprovuar**

Data e shpalosjes së DPP në anglisht:

24 korrik 2023

## Përshkrimi i projektit

Një hua senior e pasiguruar deri në 4 milionë euro për KEP Trust ("KEP") në kuadër të Kornizës për Ndërmjetësit Financiarë ("FIF"), të ardhurat e së cilës do të përdoren për kreditimin e mëtutjeshëm për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme ("NMVM") në Kosovë në përputhje me Deklaratën e Politikës së FIF-it.

## Objektivat e Projektit

Projekti është paraparë të promovojë ndërmarrësinë dhe konkurrueshmërinë e tregut duke rritur disponueshmërinë e financimit për NMVM-të në pronësi private në Kosovë, me fokus në shtrirjen rajonale, tërheqjen e klientëve të rinj NMVM dhe NMVM-ve të udhëhequra nga gratë.

## Ndikimi i Tranzicionit

Rezultatet e ETI: 60

Projekti kontribuon në objektivat e FIF-it, duke mbështetur cilësitë e Ndikimit të Tranzicionit si **Konkurrues** dhe **Rezilient**:

**Konkurrues:** Projekti do të kontribuojë në ndërtimin e një sektori financiar më konkurrues duke rritur kreditimin e KEP-it për NMVM-të në pronësi private në Kosovë, me fokus në shtrirjen rajonale dhe tërheqjen e klientëve të rinj.

**Rezilient:** Projekti do të kontribuojë për reziliencën e sektorit financiar duke siguruar praktika të kujdesshme kreditimi dhe cilësi të përshtatshme të portofolit.

## Informata për Klientin

KEP TRUST

KEP Trust ("KEP") është institucioni më i madh mikrofinanciar ("IMF") në Kosovë, i organizuar si organizatë joqeveritare ("OJQ"). KEP-i u themelua në gusht të vitit 1999 me kontribute nga organizata humanitare Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Migracionin - Zvicër, dhe Klubi i Biznesit i Prizrenit.

## Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

4,000,000.00 EURO

## Gjithsej Kosto të Projektit

4,000,000.00 EURO

## Shtueshmëria

Shtueshmëria arrihet duke kombinuar financimin e nevojshëm afatgjatë në formën e një huaje senior.

## Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategoria FI (PMS 2019). KEP është klient ekzistues dhe Raporti i Vjetor për MS i KEP-it për vitin 2022 demonstroi përmirësim të performancës mjedisore dhe sociale të KEP-it, duke qenë kështu në pajtueshmëri me kërkesat relevante të performancës nga ana e Bankës. KEP-it do t'i kërkohet të vazhdojë të zbatojë procedurën e menaxhimit të riskut mjedisor dhe social për kreditë për ndërmarrje mikro, NMV-të dhe korporatat, si dhe të jetë në pajtueshmëri me Kërkesat e Performancës (KP-të) 2, 4 dhe 9 të BERZH-it, duke përfshirë respektimin e Listës së zgjeruar të BERZH-it për Përjashtimet për MS dhe Listës së Referimeve të prezantuar me PMS 2019, si dhe të dorëzojë në Bankë raporte vjetore për MS.

## Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi me Grante

Asnjë.

## Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Shpend Nura  
shnura@keptrust.org

+383 38 722 733  
<https://keptrust.org/>  
Rr. Pashko Vasa nr. 6, 10000 Prishtinë, Kosovë

## Përditësimi i fundit i DPP-së

24 korrik 2023

## Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

## Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: [procurement@ebrd.com](mailto:procurement@ebrd.com)

## Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

## Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe

ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

## Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efektive për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek [compliance@ebrd.com](mailto:compliance@ebrd.com). Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdo gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

## Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

## Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit në

nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktjnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit [ipam@ebrd.com](mailto:ipam@ebrd.com) për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.